



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-030

Prishtinë, më 27 korrik 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 KORRIK 2015

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Slavko Simić, Valdete Bajrami dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE: Floriana Shala,
Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e nënkryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 20 korrik 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 20 korrik 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 korrik 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryesia, me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 30 korrik 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.
6. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve:

1. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së për vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, prej 6-8 korrik 2015

Kryesia u njoftua nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FKS-së lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, prej datës 6-8 korrik 2015.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale